

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi kryetare e kolegjit, Gani Zabeli dhe Afrim Shala anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Jeton Leci, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.J. nga fshati ..., Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale vjedhje pylli në vazhdim, nga neni 358 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr.99/2016, datë 31.08.2018 në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK), me datë 04.12.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr.99/2016, datë 31.08.2018 ndryshohet vetëm përkitazi me vendimin për dënim me burgim, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit B.J. për veprën penale vjedhje e pyllit në vazhdim, nga neni 358 par. 2 të KPRK-së për të cilën është shpallë fajtor, më afër të përshkruara si në dispozitivin e aktgjyqimit të ankimuar, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, e të cilin dënim obligohet ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa dënimin e shqiptuar me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) €, e merr si të vërtetuar, e të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën i njëjti konform dispozitës së nenit 46 par. 3 të KPRK-së do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, duke ia llogaritur 1 (një) ditë burgim në 20 € të gjobës.

II. Aktgjykimi i ankimuar në pjesët tjera ngel i paprekur.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti, me aktgjykimin P.nr.99/2016, datë 31.08.2018, të akuzuarin B.J. e ka shpall fajtorë për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit në vazhdim, nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënimin me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) €, të cilin dënim është obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, në të kundërtën i njëjti konform nenit 46 par. 3 të KPRK-së do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, duke ia llogaritur një ditë burgu në 20 € të gjobës, dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90

(nëntëdhjetë) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale. Është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 25 €, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara APK, Zyra në Viti, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe atë vetëm për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim me burgim më të ashpër.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1130/18, datë 31.10.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurori të Prokurorisë Themelore në Gjilan të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim me burg efektiv dhe më i ashpër.

Gjykata e Apelit e Kosovës konform nenit 390 të KPP-së e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit, për të cilën i njoftoj palët dhe atë Prokurorin e Apelit, të dëmtaren AKP – Zyra në Viti dhe të akuzuarin B.J., mirëpo edhe pse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt, në seancë nuk prezantuan asnjëra nga palët.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPP-së dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPP-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPP-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket bazës ankimore lidhur me vendimin për dënim, Prokurori në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënimin e merituar sipas ligjit, sepse rrethanat lehtësuese çfarë do qofshin ato, assesi nuk kanë guxuar të vlerësohen se janë të asaj rëndësie që të ndikonin që dënimin e paraparë ligjorë për këtë vepër të zbutet gjerë në atë nivel, çka

do të thotë se në rastin konkret fare nuk janë vlerësuar rrethanat rënduese dhe atë fakti se i akuzuari në vazhdimësi ka kryer veprën penale të vjedhjes së pyllit, duke dëmtuar pyllin e pronës shtetërore në vëllim të përgjithshëm prej 44.58 metër kub, e cila rrethanë paraqet rrethanë veçanërisht rënduese për natyrën veprës penale. Më tej, theksohet se dënimi i shqiptuar të akuzuarit në rastin konkret nuk është në proporcion me peshën e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të saj, si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe se me dënime kaq të buta nuk do të arrihet qëllimi i ndëshkimit ndaj të akuzuarit që në të ardhmen mos të kryej vepra të tilla penale, e as që mund të ndikoj në mënyrë preventive edhe ndaj qytetarëve tjerë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme ankimore të prokurorit janë pjesërisht të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit dhe llojit të lartësisë së dënimit, drejtë i ka vlerësuar dhe konstatuar të gjitha rrethanat konform dispozitave të nenit 73 të KPRK-së, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh gjendjen e tij ekonomike, faktin se është i papunë, mbajtës i familjes, baba i pesë fëmijëve, ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë penale, se verën penale e ka kryer me dashje dhe vetëdije të plotë, dëmin e shkaktuar të dëmtuarës, si dhe faktin se është bërë dukuri e shpeshtë kryerja e veprave penale të vjedhjes së pyllit.

Vlerësimin e këtyre rrethanave relevante për matjen e dënimit e pranon edhe kjo gjykatë, mirëpo kjo gjykatë konsideron se rrethanat e këtyra të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, pasojat dhe lartësinë e dëmit të shkaktuar të dëmtuarës, ku i akuzuari me qëllim të përfitimit material ka prerë 59 trungje në vëllim të përgjithshëm prej 44.58 metër kub, nuk justifikojnë shqiptimin e dënimit me burgim e të kushtëzuar si të mjaftueshme për arritjen e qëllimit të dënimit, ngase ky dënim nuk është në proporcion me intensitetin e të mirë së mbrojtur, e as me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, prandaj duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, rrethanën se i akuzuari ka treguar vendosmëri në kryerjen e veprës penale, nga ana tjetër duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe atë se vepra penale është kryer në pyllin shoqërorë, pastaj se qëllimi i tij ka qenë përfitimi material për vete, rrethana këto që paraqesin rrezikshmërinë e shtuar shoqërore të kësaj vepre penale, andaj këto rrethana japin bazë për shqiptimin e dënimit më të ashpër, prandaj Gjykata e Apelit në Prishtinë të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga kjo gjykatë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 403 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.1126/2018 datë 04.12.2018

Bashkëpunëtori profesional
Jeton Leci

Anëtarët e kolegjit

Gani Zabeli

Afrim Shala

Kryetare e kolegjit
Shqipe Qerimi